

Përmbajtja:

- 1: Hyrje
- 2: Veprimtari kryesore
- 3: Formimi Fillestar
- 4: Formimi Vazhdues
5. Biblioteka
- 6: Agjenda e muajit mars

1. Hyrje

Të nderuar,

Me kënaqësi ju prezantojmë numrin e dytë të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, një instrument i ri komunikimi institucional, i cili synon të informojë në mënyrë të rregullt, të strukturuar dhe transparente mbi veprimtarinë e Shkollës.

2. Veprimtari kryesore

Gjatë muajit shkurt 2026, nga data 6 deri në datën 28, u zhvillua procesi i regjistrimit të konkurrentëve për provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës. Konkurrentët kishin mundësinë të zgjidhnin një, dy ose të tri profilet: gjyqtar, prokuror dhe avokat shteti.

Pas përfundimit të regjistrimeve, dokumentacioni i paraqitur nga konkurrentët po verifikohet nga Shkolla e Magjistraturës, Këshillat përkatës dhe Avokatura e Shtetit. Pas përfundimit të verifikimeve dhe miratimit nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, do të publikohet lista përfundimtare e konkurrentëve që do të marrin pjesë në provimin e pranimit.

Formimi Fillestar Zemra e magjistratëve të rinj

Regjistrimi i kandidatëve për në konkursin e pranimit 2026-2027

Muaji shkurt 2026 shënon fillimin e regjistrimeve të të gjithë të interesuarve për të konkurruar në provimin hyrës të Shkollës së Magjistraturës.

Konkurrentët, pasi ngarkuan dokumentet e nevojshme në platformën SMVSHM, i dorëzuan ato fizikisht pranë Komisionit të Pranimit të Dokumentacionit nga e hëna në të premte, nga ora 9:00 deri në orën 14.00.



*“Çdo jurist që hyn në këtë shkollë
mbart me vete një premtim për një
sistem drejtësie më të fortë.”
“Drejtësia nis nga ata që zgjedhin ta
kërkojnë dhe ta mbrojnë atë çdo
ditë.”*

Aktivitetet e muajit

- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- Zhvillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë të vitit të dytë.
- Zhvillimi i gjyqeve imituese nga kandidatët e vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata dhe prokurori.
- Zhvillimi i vlerësimit të dytë në lëndën e gjykimit penal. Përfundimi i lëndës së drejtësisë evropiane.
- Zhvillimi i vlerësimit të parë në lëndën e gjykimit kushtetues dhe gjykimit familjar, i mituri dhe viktima.

Viti i parë

Gjatë muajit shkurt vijoi procesi i mësimdhënies për kandidatët për magjistratë, ndihmës dhe këshilltarë ligjorë, si dhe për avokatë shteti, duke u aftësuar përmes praktikës dhe punës individuale nën drejtimin e pedagogëve të lëndëve përkatëse. Kandidatët iu nënshtruan katër vlerësimeve të rëndësishme.

Paralelisht me procesin mësimor, kandidatët për ndihmës dhe këshilltarë ligjorë zhvilluan edhe praktikën profesionale në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në fokus: “Jo vetëm studimi, por formimi i mendjes kritike, i karakterit profesional dhe i ndershmërisë.”

Viti i dytë

Në kuadër të programit të formimit fillestar, viti i dytë filloi lëndën e psikologjisë dhe kursin me karakter praktik klinika ligjore.

Gjatë zhvillimit të orëve teorike të Klinikës Ligjore, kandidatët patën mundësinë të udhëhiqeshin nga pedagogë të shquar, të cilët sjellin një përvojë të pasur dhe një vizion të qartë mbi profesionin e së drejtës.

Zhvillimi i gjyqeve imituese



Gjatë muajit shkurt 2026, kandidatët për magjistratë të vitit të dytë zhvilluan një sërë gjyqesh imituese në lëndët e së drejtës penale dhe civile, nën udhëheqjen e pedagogëve dhe gjyqtarëve të specializuar. Fabulat e përzgjedhura nga kandidatët përfshinë çështje penale, si vrasja e mbetur në tentativë, veprat penale të lidhura me marrëdhëniet familjare, prodhimin dhe shitjen e narkotikëve, kultivimin e bimëve narkotike, si dhe armëmbajtjen pa leje. Në këto çështje u trajtuan në mënyrë të thelluar institute të rëndësishme të së drejtës procedurale penale, si zëvendësimi i masave të sigurimit personal, pavlefshmëria dhe papërdorshmëria e provave, administrimi i provave, kundërshtimi i dëshmive, si dhe roli i gjyqtarit të seancës paraprake.



Po gjatë këtij muaji, kandidatët zhvilluan edhe gjyqe imituese në lëndën e së drejtës civile, ku u trajtuan fabula që lidhen me pavlefshmërinë e veprimeve juridike, konfliktet mbi pasuritë e bashkëshortëve, pavlefshmërinë e testamenteve, si dhe mosmarrëveshjet lidhur me trashëgiminë, përfshirë rastet kur testamenti është hartuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto procese u analizuan institute civile, si: juridiksioni, kompetenca, ndërhyrja kryesore, vlefshmëria e

testamenteve, rezerva ligjore, dhe vlera provuese e akteve noteriale e gjyqësore.

Gjyqet imituese të zhvilluara gjatë muajit shkurt u karakterizuan nga profesionaliteti i kandidatëve, një zbatim rigoroz të dispozitave procedurale dhe materialeve ligjore, si dhe një përfshirje aktive në debatin gjyqësor. Ato shërbyen si një bazë praktike që i mundësoi kandidatëve të ushtrorjnë rolet e gjyqtarit, prokurorit dhe mbrojtësit, duke përforcuar aftësitë e tyre analitike dhe argumentuese, si dhe duke i afruar një hap më pranë realitetit të punës gjyqësore.



“Përmes gjyqeve imituese, kandidatët ushtrorjnë të menduarit kritik, argumentimin dhe vendimmarrjen: tri aftësi që ndërtojnë themelet e një magjistrati të mirëformuar.”

Viti i tretë

Kandidatët e vitit të tretë vijojnë praktikën profesionale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në dhomat civile dhe penale, si dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjatë kësaj periudhe ata po njihen në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionimin praktik të institucioneve të drejtësisë, përmes pjesëmarrjes aktive në ndjekjen e çështjeve gjyqësore dhe procedurave hetimore. Ky angazhim u ka mundësuar kandidatëve të

fitojnë njohuri të thelluara mbi zbatimin e legjislacionit material dhe procedural dhe të kuptojnë dinamikat reale të proceseve gjyqësore dhe të veprimeve hetimore.

Paralelisht, kandidatët po japin kontribut konkret në punën e përditshme të institucioneve pritëse, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatës, duke zhvilluar aftësi profesionale, etike dhe praktike të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, kandidatët kanë marrë pjesë edhe në trajnimet e dedikuara të organizuara posaçërisht për ta nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat kanë shërbyer për të thelluar përgatitjen e tyre teorike dhe praktike dhe për të mbështetur zhvillimin e kompetencave profesionale në të gjitha fushat e formimit. “Në vitin e tretë të praktikës, kandidatët kuptojnë se drejtësia nuk është vetëm dije. Ajo është disiplinë, përkushtim dhe aftësi për të marrë vendime të drejta në kohën e duhur.”

Orari për muajin mars

MUJI MARS										
Orari	E hënë 2		E martë 3		E mërkurë 4		E enjte 5		E premte 6	
Jave 21	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2
8:30 - 11:20	GJA 6	GJF6	GJC6	GJP6	GJP6	GJC	GJF6	GJA6	Vlerësim 2	GJK
12:00 - 14:50	GJA		GJC	GJP	GJP	GJC		GJA		
Orari	E hënë 9		E martë 10		E mërkurë 11		E enjte 12		E premte 13	
Jave 22	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2
8:30 - 11:20	GJA6	GJF6	GJC	GJP	GJP	GJC	GJK8	GJA	GJF	GJK8
12:00 - 14:50	GJA		GJC	GJP	GJP	GJC		GJA		
Orari	E hënë 16		E martë 17		E mërkurë 18		E enjte 19		E premte 20	
Jave 23	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2
8:30 - 11:20			GJC	Vlerësim	GJC4	GJK	GJA	GJF		
12:00 - 14:50			GJC	Vlerësim	GJF	GJC4	GJK	GJA		
Orari	E hënë 23		E martë 24		E mërkurë 25		E enjte 26		E premte 27	
Jave 24	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2
8:30 - 11:20			GJC	GJP	GJP	GJC	GJA	GJK4	Vlerësim 2	GJF
12:00 - 14:50			GJC	GJP	GJP	GJC	GJK4	GJA		
Orari	E hënë 30		E martë 31		E mërkurë		E enjte		E premte	
Jave 25	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2
8:30 - 11:20	GJA6	GJF6	GJC5	GJP						
12:00 - 14:50	GJA		GJC	GJP						

Formimi Vazhdues Për një drejtësi cilësore

Gjatë muajit shkurt 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 20 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 410 pjesëmarrës (jo pjesëmarrës individual).

Trajnimet mbuluan fusha prioritare si **prokurimi publik dhe konkurrenca, trafikimi i narkotikëve, si dhe viktimat dhe i mituri në procesin penal**, me pjesëmarrje të synuar të strukturave të specializuara, përfshirë prokurorë të strukturave të posaçme dhe gjyqtarë të juridiksioneve përkatëse. Gjithashtu, u zhvilluan module në fushën e **marrëdhënieve të punës, sigurimeve shoqërore, të drejtës familjare dhe të miturve, si dhe pronësisë industriale**.



Trajnimi 2 shkurt 2026, “Prokurimi publik”



Trajnimi 9 shkurt “Pensionet dhe sigurimet shoqërore”



**Trajnim datë 25-26 shkurt 2026
“Marrëdhëniet e punës”**



Trajnimi datë 11 shkurt 2026 “Narkotikët”

Gjatë muajit shkurt u zhvilluan edhe dy trajnime 1-ditore të dedikuara për inspektorët e ILD, ku u trajtuan çështje si shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit si Drejtues i Prokurorisë; Pavarësia procedurale e prokurorit si dhe kuadri ligjor/nënligjor që rregullon marrëdhëniet e tyre me drejtuesin e prokurorisë, prokurorët e Apelit si dhe Prokurorin e Përgjithshëm, me qëllim forcimin e njohurive dhe standardeve profesionale të inspektorëve.



**Trajnimi datë 16 shkurt 2026
“Markat tregtare”**



Trajnime 15 - 16 shkurt 2026 “Shkeljet disiplinore”, “Pavarësia procedurale e prokurorit”

Fokusi i veçantë gjatë këtij muaji ishte edhe integrimi i tematikave bashkëkohore, si **inteligjenca artificiale në hetimet penale, mbrojtja e të dhënave personale sipas kuadrit të ri ligjor, si dhe e drejta e shtetësisë dhe të drejtat e minoriteteve**, duke reflektuar zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë dhe nevojat e praktikës.



Trajnimi datë 5 shkurt 2026 “Inteligjenca artificiale dhe etika e prokurorit”



Trajnimi datë 12 shkurt “E drejta e shtetësisë dhe minoriteteve”



Trajnimi datë 23 shkurt “E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale”

Më 18 shkurt, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i paraqiti Shkollës së Magjistraturës një Manual mbi Prokurimin Publik për gjyqtarë dhe prokurorë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit për t'u përballur në mënyrë efektive




me veprat penale komplekse që lidhen me prokurimin publik.

Manuali ofron udhëzime praktike për gjyqtarët, prokurorët dhe praktikuesit ligjorë mbi identifikimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale që lidhen me prokurimin, duke u mbështetur në kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore përkatëse. Ky botim synon të forcojë integritetin, të promovojnë qëndrueshmërinë në gjykim dhe të rrisë llogaridhënien, duke kontribuar në reformat e vazhdueshme anti-korrupsion të Shqipërisë.

Për muajin Mars janë planifikuar:

- 21 trajnime të formimit vazhdues

Biblioteka



Biblioteka e Shkollës së Magjistraturës vazhdon të pasurohet me literaturë të re juridike për të mbështetur sa më mirë studimin dhe

punën tuaj. Biblioteka nuk është vetëm një hapësirë librash, por dhe një hapësirë studimi dhe një pikë mbështetjeje për kërkimin e informacionit në burime elektronike dhe databaza juridike.

Ju sugjerojmë të shfletoni katalogun digjital të Bibliotekës për tu njohur më mirë me përmbajtjen e fondit të librave dhe të regjistroheni si përdorues në bibliotekën digjitale që të përfitoni qasje në tekst të plotë për botime të Shkollës.

Ju mirëpresim në ambientet e bibliotekës dhe ju ftojmë të përfitoni nga burimet dhe shërbimet në dispozicion.

Mbledhje e Këshillit Drejtues - 2 shkurt 2026

Në mbledhjen e datës 2 shkurt 2026, të zhvilluar në ambientet e Gjykata e Lartë, Këshilli Drejtues i Shkolla e Magjistraturës fillimisht shqyrtoi dhe miratoi shpalljen e vendeve vakante për kandidatët për magjistratë dhe avokate shteti, bazuar në propozimet e ardhura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Avokati i Shtetit, si dhe u trajtua caktimi i datave të provimit të pranimit. Gjithashtu, Këshilli shqyrtoi dhe miratoi disa ndryshime në kalendarin e Formimit Vazhdues për vitin akademik 2025–2026, si dhe Raportin Ekonomik dhe Financiar për vitin buxhetor 2025. Në përfundim, u diskutua publikimi i listës së kandidatëve që kanë kaluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga këshillat përkatës.

Mbledhje e Këshillit Pedagogjik 13 shkurt 2026

Më 13 shkurt 2026, në mjediset e Shkollës së Magjistraturës u zhvillua mbledhja e Këshillit Pedagogjik, ku u diskutuan çështje thelbësore për funksionimin akademik të institucionit bazuar në ndryshimet e fundit ligjore, përfshirë programin e provimit për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kompetencat profesionale të kërkuara për këtë kategori, strukturën, mënyrën e vlerësimit dhe përcaktimin e datës së provimit të pranimit, si edhe procedurat për ndihmësit ligjorë që synojnë të konkurrojnë për profilin “magjistrat”.



Ju ftojmë të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,

Shkolla e Magjistraturës
www.magjistratura.edu.al

E-mail: info@magjistratura.edu.al

AGJENDA E MUAJI MARS

Kalendari i trajnimeve

MARS 2026				
1.	MODUL b.4 “MARRËDHËNIET E PUNËS” Rastet e ngacmimit dhe dhunës seksuale si dhe diskriminimit gjinor në vendin e punës, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Konventa C-190 si dhe nga direktiva të tjera përkatëse të BE.		Ekspertë: Arta Mandro Ervin Pollozhani Lehtësues: Rudi Laze	2 mars 2026
2.	MODUL a.11 “SIGURIMI I PROVËS” Rastet e sigurimit të provës. Subjektet që mund të kërkojnë sigurimin e provës. Vendimmarrja e gjykatës në rast ankimi të viktimës ndaj vendimit të prokurorit për mospranimin e kërkesës për sigurimin e provës. Procedura ligjore për paraqitjen e kërkesës dhe pasojat e mosrespektimit të afateve të parashikuara në ligj.		Ekspertë: Klodian Kurushi Lehtësues: Klejda Çapja (Meçi)	4 mars 2026
3.	Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e provës. Procedura e sigurimit të provës në rastin e të miturve.		Ekspertë: Igerta Hysi Elida Kaçkini Lehtësues: Enkel Peza	5 mars 2026
4.	MODUL a.10 “VIKTIMA DHE I MITURI NË PROCESIN PENAL” Kuptimi i “personit të besuar”, kriteret e vlerësimit të përshtatshmërisë së personit të besuar, parashikimet e		Ekspertë: Aurela Anastas	9 mars 2026



Buletin informativ Shkolla e Magjistraturës

Janar 2026
Nr. 1

	ndryshme ligjore dhe zbatimi në praktikë. Mbrojtja e konfidencialitetit, Direktiva 2012/29 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25.10.2012, lidhur me të drejtat e viktimës. Mbrojtja e privatësisë së viktimës së veprës penale si një mjet të rëndësishëm për të parandaluar viktimizimin e dytë dhe të përsëritur. Regjistrimi i bisedës me viktimën me mjete audiovizive dhe mundësia e përdorimit të saj si provë në procedimin penal.		Nurjeta Pogaçe Lehtësues: Klejda Çapja (Meçi)	
5.	Padia civile në procesin penal. Afati për legjitimin e paditësit civil. Sigurimi i padisë civile në procesin penal sipas nenit 63 të Kodit të Procedurës Penale, dallimi me sigurimin e padisë sipas nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile. Heqja dorë nga gjykimi i padisë civile sipas parashikimit në nenin 64 të Kodit të Procedurës Penale dhe dallimet me të drejtën e heqjes dorë sipas nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile. Praktika gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 64 të Kodit të Procedurës Penale. Efektet e vendimit të pushimit të çështjes/pafajësisë mbi padinë civile në procesin penal.		Ekspertë: Margarita Buhali Saida Dollani Lehtësues: Thomaidha Roça	<u>10 mars 2026</u>
6.	MODUL a.11 “SIGURIMI I PROVËS” Marrja e provës, pajtueshmëria e gjykatës që disponon për marrjen e provës me gjykatën e themelit. Ankimi ndaj vendimit për sigurimin e provës dhe efektet e vendimmarrjes së gjykatës mbi gjykimin në themel.		Ekspertë: Ardit Mustafaj Albert Meça Lehtësues: Ervin Sulaj	<u>11 mars 2026</u>
7.	MODUL e.2 “MEDIA” Marrëdhëniet e gjykatave me median. Qëllimi kryesor i komunikimit. Aktorët që “duhet” e që “munden” të komunikojnë me median apo me audienat. Përparësitë dhe kufizimet. 2. Liria e shprehjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kufizimet në lirinë e shprehjes për gjyqtarët dhe prokurorët. Sekreti hetimor dhe liria e shprehjes.		Ekspertë: Zylyftar Bregu Perikli Zaharia Lehtësues: Marinela Osmani (Nuni)	<u>12 mars 2026</u>



8.	Mjetet e komunikimit, tradicionale dhe digjitale, përparësitë dhe kufizimet. Njoftimi për shtyp, Konferenca për shtyp, Intervista. Format moderne të komunikimit të drejtpërdrejtë me opinionin publik, nëpërmjet faqes së internetit, mediave sociale, mesazhe të filmuara, etj. Liria për tu shprehur on line nëpërmjet portaleve të lajmeve në internet; qasja në informacionet, opinionet dhe shprehjet e të tjerëve, nga njëra anë, dhe respektimi i reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, përfshirë edhe të drejtën e tyre për privatësi, nga ana tjetër. - Censura, shpifja dhe fyerja.		Ekspertë: Gent Ibrahim Edlira Petri	<u>13 mars</u> <u>2026</u>
9.	MODUL b.2 “ÇËSHTJE TË SË DREJTËS FAMILJARE DHE TË MITURVE” Problematika të hasura në praktikën gjyqësore për zbatimin e Konventës së Hagës Për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, 1980, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9446/2005. Shtyllat kryesore dhe funksionet e Konventës, mjetet në dispozicion dhe kuptimi i instituteve, fusha e zbatimit. Kuptimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës në rastet e rrëmbimit civil ndërkombëtar. Marrëdhëniet ndërmjet Konventës së Hagës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së.		Ekspertë: Aida Bushati Arta Mandro	<u>17 mars</u> <u>2026</u>
10.	MODUL a.2 “PASTRIMI I PARAVE” Trajnim mbi hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parasë duke përfshirë rastet komplekse dhe ato të lidhura me korrupsionin. Hetimi i veprës penale të pastrimit të parave dhe kompleksiteti i tij. Niveli i provueshmërisë përpara gjykatës lidhur me origjinën e pasurisë. Vlera e aktit të ekspertimit kontabël dhe kujdesi që duhet të tregohet në caktimin e detyrave të ekspertit.		Ekspertë: Idlir Peçi Nertina Kosova	<u>18 mars</u> <u>2026</u>
11.	Trajnim 1 ditor Teknikat Forensic të trajtimit të provave	<u>Në bashkëpunim me</u>	Ekspert	<u>18 mars</u> <u>2026</u>



	Grupi i synuar kandidatë për gjyqtarë viti III, gjyqtarët e rinj (5 vite)	<u>Ambasadën Britanike</u>	Ylli Pjetërnikaj Ekspertë nga Ambasada UK	
12.	Trajnim 1 ditor Teknikat Forensic të trajtimit të provave Grupi i synuar kandidatë për prokurorë, viti III, gjyqtarët e rinj (5 vite)	<u>Në bashkëpunim me Ambasadën Britanike</u>	Ekspert Ylli Pjetërnikaj Ekspertë nga Ambasada UK	<u>19 mars 2026</u>
13.	Tema 1: Paragjykimi dhe njëanshmëria e pavetëdijshme (konjitive) në gjykim si procese që ndikojnë në mënyrën se si magjistratët analizojnë dhe vendosin rreth rasteve gjyqësore. Reduktimi i efektit të paragjytimeve dhe njëanshmërisë së pavetëdijshme në gjykim, për të minimizuar ndikimin: e stereotipeve dhe përvojave personale; e mediave dhe shoqërisë; e presionit profesional dhe kulturës gjyqësore si dhe njohurive të përziera me emocionet. Tema 2: Inteligjenca emocionale dhe stresi, aftësi thelbësore e magjistratëve për të funksionuar në mënyrë efektive dhe për të mbajtur një performancë të lartë në detyrën e tyre, duke u fokusuar tek identifikimi i ndjenjave, menaxhimi i ndjenjave, identifikimi i ndjenjave të të tjerëve si dhe menaxhimi i marrëdhënieve me të tjerët.		Ekspertë: Sokol Berberi Arben Isaraj Lehtësues: Marta Bej	<u>19 mars 2026</u>
14.	Individualizimi i figurave të veprës penale të korrupsionit. Tipizimi i korrupsionit aktiv, ndërmjetësimit për korrupsion dhe korrupsionit. Përcaktimi i përgjegjësisë penale të ndërmjetësit korruptiv. Fusha e zbatimit të nenit 245/1 në raport me figurat e posaçme të veprave penale të korrupsionit. Veprimet hetimore dhe mjetet e posaçme të kërkimit të provës në veprat penale të korrupsionit.		Ekspertë: Engert Pëllumbi Albert Meça Lehtësues: Dorina Bejko	<u>24 mars 2026</u>



Buletin informativ Shkolla e Magjistraturës

Janar 2026
Nr. 1

15.	MODUL b.2 “ÇËSHTJE TË SË DREJTËS FAMILJARE DHE TË MITURVE” Drejtësia miqësore për të miturit. Teknikat e intervistimit të të miturve.		Ekspertë: Ilir Panda Marjeta Zaimi Lehtësues: Alma Felaj	<u>25 mars</u> <u>2026</u>
16.	MODUL a. 9 “KORRUPSIONI” Korrupsioni dhe prokurimi publik; Palët që mund të përfshihen në veprime korruptive aktive ose pasive dhe metodat për hetim dhe gjykim në këto raste. Target grupi parësor: Prokurorë të SPAK dhe Gjyqtarë të GJKKO		Ekspertë: Ylli Pjetërnikaj Bledar Maksuti Lehtësues: Adnan Hoxha	<u>25 mars</u> <u>2026</u>
17.	MODUL a.2 “PASTRIMI I PARAVE” Veprat penale në fushën e tatimeve dhe evazioni fiskal. Pastrimi i parave, detyrimet ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Koncepti i rikuperimit të produkteve të veprës penale.		Ekspertë: Amarildo Laçi Elion Mustafaj Lehtësues: Florian Boriçi	<u>26 mars</u> <u>2026</u>
18.	Ligji antimafia. Zbatimi i tij në praktikë dhe lidhja midis hetimit pasuror dhe procedimit penal të pastrimit të parave. Parashikimet ndërkombëtare lidhur me konfiskimin e produkteve të veprës penale. Rëndësia e konfiskimit në luftën kundër pastrimit të parave. Ndihma ndërkombëtare në dispozicion kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.		Ekspertë: Bib Ndreca Anita Jella Lehtësues: Endrit Blmi	<u>27 mars</u> <u>2026</u>
19.	Trajnim 1 ditor Ekuilibrimi i së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare me lirinë e shprehjes: Analizë e standardeve interpretative të Gjykatës Evropiane të të		Ekspertë: Mariana Semini	<u>27 mars</u> <u>2026</u>



Buletin informativ Shkolla e Magjistraturës

Janar 2026
Nr. 1

	Drejtave të Njeriut mbi mbrojtjen e të drejtave të personalitetit në mjedise fizike dhe digjitale.		Edlira Petri Lehtësues Miranda Nakaj	
20.	MODUL a.9 “KORRUPSIONI” Kuptimi dhe zbatimi i bashkëpunimit në rastet e korrupsionit. Praktika gjyqësore. Korrupsioni dhe bashkëpunimi me krimin e organizuar.		Ekspertë: Idlir Peçi Dorina Bejko Lehtësues: Anita Jella	<u>30 mars</u> <u>2026</u>
21.	Korrupsioni, shpërdorimi i detyrës, shkelja e barazisë në prokurime, marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, kufijtë ndarës dhe dallimet e këtyre veprave penale. Kompetenca lëndore e prokurorisë dhe gjykatës për hetimin, gjykimin dhe ekzekutimin e dënimeve penale të korrupsionit.		Ekspertë: Irena Gjoka Engert Pëllumbi Lehtësues Ermira Manelli	<u>31 mars</u> <u>2026</u>